



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve në Hapësirën Kibernetike

Përmbajtja

1.	Hyrje	3
2.	Misioni dhe Qëllimi	3
3.	Parimet Themelore të Politikës	3
4.	Hapat për Zbatimin Politikës	3
5.	Referencat	4
6.	Frekuenca e Rishikimit	4

1. Hyrje

Rritja e përdorimit të internetit dhe teknologjisë nga fëmijët në Shqipëri ka evidentuar nevojën për adresimin e rreziqeve që burojnë nga hapësira kibernetike. Fëmijët ekspozohen shpesh ndaj kërcënimeve të ndryshme online, të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre emocional, mendor dhe shoqëror.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve në Hapësirën Kibernetike synon të krijojë një mjedis digjital më të sigurt për fëmijët, përmes ndërmarrjes së masave të strukturuar për mbrojtjen, edukimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me përdorimin e sigurt të internetit dhe teknologjive digjitale.

2. Misioni dhe Qëllimi

Misioni i kësaj politike është krijimi i një hapësire kibernetike të sigurt, të mbrojtur dhe të përshtatshme për fëmijët në Republikën e Shqipërisë.

Qëllimi i politikës është edukimi, informimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit, duke promovuar një përdorim të sigurt, të përgjegjshëm dhe të dobishëm të teknologjisë. Për realizimin e këtij qëllimi, politika parashikon ndërmarrjen e masave konkrete, përfshirë zhvillimin e platformave edukative online, zbatimin e programeve të sigurisë kibernetike në shkolla dhe forcimin e bashkëpunimit me komunitetin teknologjik dhe organizatat e shoqërisë civile.

3. Parimet Themelore të Politikës

Politika bazohet në parimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve, përfshirjen e palëve të interesuara, promovimin e përdorimit të sigurt dhe të përgjegjshëm të teknologjisë nga fëmijët, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve institucionale dhe të bashkëpunimit me sektorin privat, komunitetin teknologjik dhe shoqërinë civile. Gjithashtu mbështetet në parimet e transparencës, llogaridhënies, qëndrueshmërisë dhe përputhshmërisë ligjore, duke garantuar një mjedis digjital më të sigurt për fëmijët në Shqipëri.

4. Hapat për Zbatimin Politikës

Mjete dhe Masa Konkrete

- Krijimin e një platforme informative dhe edukative online për fëmijët, prindërit dhe mësuesit, që ofron informacion mbi rreziqet në hapësirën kibernetike dhe mënyrat e sigurta të përdorimit të internetit;
- Promovimin dhe integrimin e programeve shkollore që përfshijnë edukimin mbi sigurinë kibernetike dhe përdorimin e sigurt të internetit në të gjitha nivelet e arsimit;
- Përdorimin e teknologjive dhe mjeteve të përshtatshme për monitorimin dhe parandalimin e rreziqeve potenciale online, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë;
- Bashkëpunimin me komunitetet teknologjike, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë relevantë për mbështetjen e zbatimit të politikës dhe trajnimin e personelit arsimor në çështjet e sigurisë kibernetike.

Monitorimi dhe Vlerësimi:

Zbatimi i politikës monitorohet përmes:

- krijimit të një komisioni ekspertësh për ndjekjen e zbatimit të politikës, identifikimin e sfidave dhe formulimin e rekomandimeve për përmirësime;
- raportimit periodik dhe vlerësimin të vazhdueshëm të ndikimit të masave të ndërmarra në sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, me qëllim garantimin e efektivitetit të politikës dhe përshtatjen e saj sipas nevojës.

Financimi:

Zbatimi i kësaj politike mbështetet në alokimin e fondeve nga buxheti i shtetit. Përveç kësaj, mundësohet sigurimi i financimeve shtesë përmes donacioneve dhe burimeve të tjera financiare nga organizata ndërkombëtare dhe sektori privat, me qëllim garantimin e një mbështetjeje të qëndrueshme për iniciativat e parashikuara.

Kalendari i Zbatimit:

Brenda gjashtë muajve nga miratimi i politikës, parashikohet nisja e fushatave informuese dhe trajnimeve për prindërit dhe edukatorët, me qëllim përgatitjen e tyre për adresimin e sfidave të sigurisë kibernetike.

Ndërsa, brenda një viti nga miratimi i politikës, do të zhvillohet dhe funksionalizohet platforma informative online, e cila do të ofrojë burime edukative dhe mbështetje për përdorimin e sigurt të internetit nga fëmijët.

5. Referencat

Kjo politikë mbështetet në legjislacionin kombëtar për sigurinë kibernetike, Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, si dhe në praktikën dhe standardet ndërkombëtare të njohura në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në hapësirën kibernetike.

6. Frekuenca e Rishikimit

Ky dokument duhet të rishikohet të paktën një herë në vit ose kur ka ndryshime të rëndësishme në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit në institucion.